



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më .04.2026

**MBLEDHJA Nr. 17,**  
**Datë 09.04.2026, ora 11:00**  
**e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte , datë 09.04.2026, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr.17, e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Mars 2026 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY PESHK” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW.
4. Mbi heqjen e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “ENERGY MARKET ALBANIA” sh.p.k.
5. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k, për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.
6. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**